

NURI DRAGOJ

**TREVA E PËRMETIT PËRBALLË PUSHTIMIT ITALIAN
(1916-1920)**

Në këtë artikull jam përpjekur të paraqes rezistencën e përmetarëve gjatë presionit italian e grek, në vitet 1919-1920, bazuar kryesisht në dokumente arkivore. Ishte koha kur kufijtë e Shqipërisë nuk ishin përcaktuar ende, ndërsa Italia dhe Greqia punonin në fshehtësi për zbatimin e marrëveshjes Titoni-Venizellos. Në bashkëpunim me njeri-tjetrin, ata tentuan të fusnin përçarjen midis banorëve të dy besimeve të asaj treve, me qëllim që të justifikonin nevojën e pranisë së një fuqie të huaj. Po ashtu, organizuan një kryengritje në fshatrat e krahinës së Rrëzës, me të cilën donin t'i tregonin Konferencës së Versajës se, një pjesë e krahinave të Përmetit, nuk dëshironin të ishin nën administrimin e shtetit shqiptar, por të bashkoheshin me Greqinë. Gjithsesi, përmetarët, në unitet të plot dhe me çdo mjet, kërkuan të ishin pjesë e pandarë e shtetit shqiptar.

Revolta përmetare

Në vjeshtën e vitit 1916, grekët u larguan nga Përmeti dhe vendin e tyre e zunë italianët. Më 3 qershor 1917, ata premtuan nga Gjirokastra, se do të ndihmonin në krijimin e një shteti shqiptar të pavarur, me ushtri, gjykata, shkolla, të përbëra dhe të drejtuara nga shqiptarë.¹ Trupat italiane qenë vendosur në gjithë trevën e Përmetit, ndërsa austriakët shtriheshin mbi lumin Osum. Konflikti midis palëve vazhdonte, por komanda italiane përpiqej të shmange marrjen e Beratit prej austriakëve, pasi

¹ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë, 1912-2000*, Tiranë: Kristalina – KH, 2007, f. 95.

* *Aubrey Herbert* - kryetar i Komiteti Shqiptar të Londrës (1912-1914), në përbërje të të cilit kishte politikanë, akademikë, avokatë, gazetarë dhe synonte të tërhiqte vëmendjen e ndërkombëtarëve për situatën e frikshme që ishte krijuar në Shqipëri. Ai shërbente dhe për mbledhjen e fondeve të nevojshme për këtë çështje. Në vitin 1918, Herbert krijoi Shoqatën Anglo-Shqiptare, pasuese e atij komiteti, e cila u kujdes për çështjen shqiptare pas Luftës së Parë Botërore, ku ai qe zgjedhur përsëri kryetar i asaj shoqate, ndërsa Edith Durham, sekretare nderi e financave.

mund të rrezikohej Vlora. Megjithatë, në fund të muajit gusht, pas një lufte të ashpër dhe me shumë viktime, austriakët hynë në Berat. Herbert*, në kujtimet e tij shkruante se, në Këlcyrë, kishte parë një numër të madh burrash të plagosur e të pafjalë, që udhëtonin për Tepelenë. Midis tyre gjendeshin edhe njerëz të sëmurë, italianë dhe shqiptarë. Madje, një rreshter italian i pati thënë diplomatit britanik: “*siamo tutti mezza morti*”.²

Midis shqiptarëve dhe italianëve, fillimisht, u ndërtuan marrëdhënie të mira. Në popull ishte krijuar përshtypja, sikur ata kujdeseshin për Shqipërinë, dhe se pa mbrojtjen e tyre pavarësia mbetej e kërcënuar. Në të vërtetë Italia dukej në anë të shqiptarëve, pasi synonte të pengonte përpjekjet franceze për t’u dhënë veriun serbëve. Madje ajo kishte hyrë në konflikt dhe me jugosllavët, pasi në veri, një grup pro italian bënte propagandë në popull për domosdoshmërinë e protektoratit të Romës mbi Shqipërinë.³ Qëllimi i saj ishte që të largoheshin edhe austriakët dhe ta zotëronte vet situatën. Në një artikull të shkruar nga Amy A. Bernardy, ku përshkruhet gjendja në jug të vendit, pas largimit të andartëve grekë, tregohet një farë optimizmi dhe duket sikur punët patën marrë udhë. Midis të tjerave, në të thuhej se, “flamuri kombëtar i Skënderbeut, i kuq me shkabë të zezë me 2 krerë, valvitet lirshëm në ndërtesat zyrtare. Gjithë zakonet e vendit po respektohen nga ushtarët italianë.... Ata punojnë me urtësi e pa bërë reklamë në tokat që kanë zaptuar nga Saranda në Përmet...”⁴

Të gjitha këto veprime krijuan një farë besimi se vuajtjet e shqiptarëve do të merrnin fund. Mirëpo, pas asaj deklarate që lidhej me mbrojtjen e tërësisë tokësore të Shqipërisë, lihej të kuptohej dhe një farë protektorati. Dyshimi hidhej nga intelektualë të informuar mbi zhvillimet politike ndërkombëtare. Pandeli Çale nga Korça dhe Mehmet bej Këlcyra, megjithëse e pranonin pushtimin italian për vendet që

² *Miku i madh i shqiptarëve, Aubery Herbert dhe krijimi i Shqipërisë së sotme. Ditar dhe letra 1904-1923*, përgatitur nga Bejtullah Destani dhe Jason Tomes, Tiranë: Via Egnatia, 2012, f. 232. “*Siamo tutti mezza morti*” (Jemi të gjithë gjysmë të vdekur).

³ Halim Purellku, *Zona e pushtimit jugosllav në Shqipëri (1918-1921)*, Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2012, f. 130-131.

⁴ “Në Përmet valvitet flamuri kombëtar”, *Gazeta Dielli*, 29 gusht 1917, f. 1.

zbrazeshin nga trupat greke, përsëri nuk qenë dakord të nënshkruanin një kërkesë të tillë, pasi ndihej fryma e protektoratit.⁵

Natyrisht, kundërshtimi i bërë nga Çale dhe Mehmet bej Këlcyra nuk ishin pa arsye. Sonnino* pohonte se për ruajtjen e ekuilibrit në Adriatik, ishte e domosdoshme të ruheshin interesat italiane, në anën e përtejme të detit.⁶ Me qëndrimin e mbajtur nga Çale dhe Këlcyra pajtohej edhe Mithat bej Frashëri. Rreziku i një protektorati ekzistonte edhe pse Italia shprehej se, qëllim të vetëm kishte mbrojtjen e Shqipërisë ndaj çdo ndërhyrjeje apo kurthi të mundshëm, për më tepër në atë kohë, kur ajo nuk kishte as qeveri legale dhe as mbrojtës real.⁷

Krahas problemeve me austriakët, Italia i druhej dhe Greqisë, e cila përpiqej të gjente momentin e duhur për të ripushtuar jugun e Shqipërisë. Athina zyrtare kishte mbështetje të hapur nga francezët, të cilët propozonin që, në ndihmë të italianëve, të vinte një divizion kompakt grek dhe të vendosej në sektorin e Këlcyrës, i cili konsiderohej më i rrezikuar.⁸ Ky hap i bërë nga francezët, nëpërmjet gjeneralit Gaucher, synonte të garantonte veriun e Korfuzit. Duke përqendruar reparte të shumta artilerie, ata besonin se mund të mbronin Otranton nga sulmet armike. Por ky projekt i Gaucher u kundërshtua nga Ferrero, i cili siguronte qëndrën, se ishte në gjendje ta mbronte territorin në fjalë me forcat e tij.⁹

Mundësia për ndërhyrjen e forcave ushtarake greke në Këlcyrë, kundërshtohej edhe nga gjenerali Diaz*. Ditët e para të janarit 1918, ai i dërgoi një letër ministrit të Luftës, Alfieri, me të cilën theksonte panevojshmërinë e bashkëpunimit me forcat ushtarake greke në Shqipëri.

⁵ Syrja Vlora, *Kujtime nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës*, përgatitën për borim Marenglen Verli, Ledia Dushku, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: "Iceberg" Publishing House, 2013, f. 168-169.

*Sidney Sonnino - ministër i Punëve të Jashtme të Italisë në vitet 1914-1919.

⁶ S. Vlora, *Kujtime nga fundi i sundimit osman ...*, f. 168-169.

⁷ *Po aty*.

⁸ *L'esercito italiano nella grande guerra 1915-1918*, Volume VII. Le operazioni fuori del territorio nazionale Albania-Macedonia-Medio Oriente, Tomo 3. Narrazione. Ministero della difesa stato maggiore dell'esercito. Ufficio storico. Roma, Tipografia Regionale, 1983, f. 102.

⁹ *Po aty*, f. 103.

*Gjenerali Diaz, duke filluar nga 8 nëntori i vitit 1917, kishte detyrën e shefit të shtabit të ushtrisë italiane.

Për këtë, kërkoi që të bisedohej edhe me aleatët, me qëllim që të evitohesh çdo përpjekje greke për të hyrë në zonën italiane.¹⁰

Francezët nuk e pritën mirë kundërshtimin italian, por njëkohësisht, nuk mund të tërhiqeshin nga planet e tyre. Meqë Italia nuk pajtohej me praninë e forcave greke, Parisi propozoi dërgimin e një divizioni francez në Këlcyrë, por edhe ky variant u kundërshtua nga gjenerali Diaz. Ai i kërkoi Romës, që forcave italiane në Shqipëri, t'u shtohesh një divizion, një brigadë dhe katër bateri.¹¹

Marrëdhëniet e francezëve me italianët u acaruan, ndonëse nuk kishin qenë asnjëherë të mira. Megjithëse gjeneral Ferrero përparoi në front, francezët nuk lëvizën nga vendi. Më 30 tetor 1918, njoftohej se gjeneral Ferreros nuk do t'i dërgoheshin përforcime nga Italia. Për pasojë, italianët u thyen. Për humbjen u fajësua Ferrero dhe komanda e lartë e largoi nga detyra. Argumenti i shkarkimit arsyetohej me nevojën për të ndryshuar taktikën.¹² Pavarësisht nga masat e marra, paqëndrueshmëria e politikës italiane ishte e dukshme. Nga njëra anë shpreheshin si dashamirës të Shqipërisë, nga ana tjetër ndalonin ardhjen e shqiptarëve nga Italia. Ky qëndrim i dyzuar i shtoi dyshimet. Lidhur me këtë çështje, një politikan shqiptar i pati thënë deputetit anglez Herbert, se “në dy xhami nuk mund të ketë falje të ndryshme”.¹³

Edhe qeveria shqiptare nuk pajtohej me planin aneksionist të Italisë. Më 7 dhjetor 1918, komanda e përgjithshme në Shqipëri, njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme, atë të luftës dhe kryeministrinë në Romë, se qeveria shqiptare nuk pranonte të lëshonte asnjë pëllëmbë tokë. Gjenerali Diaz vijonte më tej, se, në bazë të paktit të Londrës, Italia duhej të zotëronte Vlorën, Sazanin dhe një territor më të gjerë, për të garantuar mbrojtjen ushtarake të territoreve që u ishin njohur nga ndërkombëtarët. Më konkretisht, Diaz kërkonte gjithë Mallakastrën deri në Qafën e Gllavës, të cilat i patën pushtuar gjatë luftës me austriakët, dhe vijonte deri në Këlcyrë e Subash, përfshirë dhe pellgun qymyrguror të Memaliajt.¹⁴

Ndërkohë, në Paris zhvillonte punimet Konferenca e Paqes. Gassopoulos, i paraqitur në konferencë si përfaqësues i “Epirit të Veriut”,

¹⁰ *L'esercito italiano nella grande Guerra ...*, f. 102.

¹¹ *Po aty*, f. 118-119.

¹² *Po aty*, f. 102.

¹³ *Miku i madh i shqiptarëve ...*, f. 310.

¹⁴ *Po aty*, f. 128-129.

përpiqej të bindte kryeministrin francez se Jugu i Shqipërisë ishte tokë greke. Sipas tij, popullsia nga Korça në Përmet, Gjirokastër, Janinë e Prevezë, fliste greqisht, në familje dhe në treg.¹⁵ Ndërsa kryeministri grek, Venizellos, në shkurt të vitit 1919, deklaronte në konferencë se pushtimin e “Epirit të Veriut” ia kishte kërkuar ministri britanik në Athinë. Sipas tij, trupat ushtarake do të qëndronin derisa të zgjidhej çështja. Ai pohonte se kishin rënë dakord që Italia të pushtonte Vlorën dhe Greqia Epirin e Veriut, duke e venë në këtë mënyrë Konferencën e Paqes para faktit të kryer.¹⁶

Gjatë punimeve të konferencës, Italia vazhdonte të tregonte se ishte protektore e Shqipërisë. Këtë e bënte edhe nëpërmjet delegatëve shqiptarë, disa prej të cilëve ishin filoitalianë. Ajo përfitonte, pasi në një farë mënyre i njëjti roli mbrojtës nga pala shqiptare, sepse ishte shprehur për të ruajtur kufijtë e vitit 1913, në jug të vendit. Për realizimin e qëllimeve, Roma financonte anëtarë të delegacionit shqiptar, duke filluar nga Turhan Pasha, Bumçi e të tjerë. Një fakt të tillë e pohonte dhe Parashqevi Qiriazi, delegate e “Partisë Politike” në Konferencën e Paqes. Sipas saj, delegati italian, Fortunato Kastoldi*, kishte këmbëngulur disa herë t’i jepte financim, por ajo nuk kishte pranuar.¹⁷

Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore, Italia i harroi premtimet e bëra dhe forcoi regjimin ushtarak. Ajo ishte e bindur në zbatimin e Traktatit të Fshehtë të Londrës, i cili i jepte një territor të gjerë në jug të Shqipërisë. Sapo të merrte Vlorën me hiderlandin e saj, nuk do të kishte asnjë kundërshtim, që pjesë të tjera të Shqipërisë të ndaheshin midis grekëve dhe serbëve. Siç shkruan Spellanzon, Marrëveshja Tittoni-Venizellos do t’i rëndonte më tej marrëdhëniet italo-shqiptare, pasi u zbulua që, Italia binte dakord ta kalonte jugun e Shqipërisë, Sarandë,

¹⁵ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), Fondi (më tej: *F.*) 151, viti (më tej: *V.*) 1919, dosja (më tej: *D.*) 4, f. 44. Letër e Gassopoulos, pa datë, viti 1919, drejtuar kryeministrit francez.

¹⁶ *AQSH*, F.151, V.1919, D.1, f.1, Deklarata e Venizellos në Konferencën e Versajës. Dokumenti nuk ka datë.

* Kastoldi ka qenë ekspert për çështjen shqiptare dhe ato ballkanike, pjesë e delegacionit Italian. Në prill të vitit 1920, qeveria e Romës e dërgoi Kastoldin në Shqipëri si komisar i lartë, për të përçarë lëvizjen kombëtare që kishte shpërthyer në prag të Luftës së Vlorës.

¹⁷ *Kujtime dhe këngë popullore për luftën çlirimtare të viteve 1918-1920*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1970, f. 40-41.

Gjirokastrë, Përmet e Korçë, brenda kufirit të Greqisë së madhe.¹⁸ Mirëpo, me një akt të tillë nuk pajtoheshin as Fuqitë e Mëdha europiane, të cilat i bënë presion Italisë, të dënonte Marrëveshjen Tittoni-Venizellos dhe Greqia ta linte të lirë kufirin e vendosur në vitin 1913.¹⁹

Këto veprime kishin bërë që shqiptarët të humbisnin besimin dhe ta shihnin Italinë si pushtuese. Më 18 shkurt 1919, banorët e qytetit të Përmetit, u mbledhën në një miting proteste, kundër planeve të fshehta që po përgatishnin rindarjen e Shqipërisë. Ky manifestim ishte shprehje e zemëratisë popullore. Folësit hodhën poshtë kërkesat greke për jugun e Shqipërisë dhe kërkuan bashkimin e Kosovës dhe Çamërisë me shtetin shqiptar. Sipas gazetës “Dielli”, “mbi 5000 përmetarë nga qyteti dhe fshatrat, u mbledhën në një miting për të mbrojtur të drejtat e shenjta shqiptare”.²⁰ Ata ishin bashkuar, për të treguar ndjenjat e tyre kombëtare dhe për të ripohuar nevojën e pavarësisë së Shqipërisë.²¹ Njëpërmjet kësaj proteste i kërkonin Konferencës së Paqes, t’i jepte Shqipërisë kufijtë që i përkisnin etnikisht, gjeografikisht dhe historikisht.²²

Populli i Përmetit kërkonte të drejtat e veta, në mënyrë të ligjshme dhe modeste, që të mos i bëheshin Shqipërisë padrejtësi, siç i ishin bërë nga Konferenca e Londrës më 1913. Pjesëmarrësit e atij tubimi shpreheshin se qenë të gatshëm për çdo sakrificë, jo vetëm duke marrë pjesë në luftë për mbrojtjen e vendit, por edhe duke dhënë jetën për të, nuk do të kursenin edhe pikën e fundit të gjakut, qoftë edhe për një pëllëmbë tokë shqiptare. Në foltoren e tubimit u ngjiten Konstandin Tasi, Stavro Vangjel Muliçka dhe Lame Osmani, të cilët ishin të një mendimi. Për shqiptarët, nuk mund të kishte qetësi, pa fituar lirinë. Duhej të ndiqej

¹⁸ Cesare Spellanzon, *La questione d’oriente. Vinti e vincitori nei Balcani*, Milano: Edizioni “Corbaccio”, 1926, f. 268.

¹⁹ *Po aty*, f. 286.

²⁰ *Gazeta Dielli*, Nr. 1483, 27 mars 1919, f. 2. Shkrimi ka për autor F. Deno. Edhe gazeta *Corriere del Puglie*, bën fjalë për një miting të organizuar në Përmet, për vetëqeverimin e shqiptarëve, kundër pretendimeve greke. *Gazeta Populli*, 8 mars 1919, f. 3.

²¹ *Gazeta Kuvendi*, 27 shkurt 1919, f. 5. Në artikullin me titull “Lëkundje në Shqipëri kundër kërkesave greke” shkruant se, në datë 18 shkurt u mbledhën mbi 3000 shpirt për të ripohuar bujarisht parimin e mëvetësisë së Shqipërisë. U vendos të dërgohen telegrame në Paris, për t’i dhënë fuqi dërgatës shqiptare t’i qëndroj burrërisht interesave të drejta të shqiptarëve.

²² *Gazeta Dielli*, Nr. 1483, 27 mars 1919, f. 2.

e njëjta praktikë si me gjithë popujt e tjerë. Për hartimin e telegramit që iu dërgua Konferencës së Paqes në Paris, pjesëmarrësit në miting zgjodhën një komision.²³ Nëpërmjet tij, u kërkohej Fuqive të Mëdha, të merrnin masa që të korrigjoheshin gabimet e bëra në Londër ndaj Shqipërisë.

Italia edhe pse qe e sigurt në “pronësinë” e saj mbi Shqipërinë, nuk e nënvleftësonte punën propagandistike brenda vendit. Për këtë, në çdo trevë aktivizoi njerëzit e saj. Në Gjirokastrë mbështeteshin te Myfit bej Libohova, i cili përpiqej të bindte parinë, mbi të mirat që do t’u vinin shqiptarëve prej Italisë. Por jo të gjithë e shihnin me besim. Stavro Vinjau kujtonte se, në vitin 1918, ai, Koço Tasi e Rasim Babameto, dyshonin në teorinë e beut të Libohovës, që u propozonte të pranonin mbrojtjen prej Italisë, në të kundërt, prefektura e Gjirokastrës do të pushtohej nga forcat greke.²⁴ Myfiti organizoi një mbledhje, ku merrnin pjesë përfaqësues nga Saranda, Delvina, Përmeti, Leskoviku dhe Kolonja. Ndonëse pati kundërshtime nga Stavro Vinjau, Luigj Gurakuqi e ndonjë tjetër, ai e bëri takimin dhe i dërgoi një telegram Turhan Pashës, kryetar i delegacionit shqiptar në Paris.²⁵ Libohova i kërkonte kryetarit të delegacionit që t’i jepte konferencës miratimin, për të kaluar Shqipërinë e Jugut, “nën garancinë e mbrojtjen e Italisë”.²⁶ Gjithsesi, proitalianët nuk ndiheshin të qetë, pasi kishte shumë intelektualë që nuk pajtoheshin me një politikë të tillë. Për të stabilizuar gjendjen, ata kërkonin ndihmën e komandës së Vlorës, të ndërhynte për të vendosur rregull dhe qetësi, pasi disa njerëz “të pagdhendur” mund të bëheshin shkak për të krijuar shqetësime apo trazira edhe në qytetet e tjera.²⁷

Duke qenë se Konferenca e Parisit po linte mënjanë kërkesat e delegacionit shqiptar për çështjen territoriale, bazuar në parimin e

²³ *Gazeta Dielli*, Nr. 1484, Boston Mass, datë 28 mars 1919, f. 1-2. Ja dhe teksti i telegramit: “Populli i krahinës së Përmetit, i mbledhur sot në një miting proteste energjik dhe kundër kërkesave imperialiste të Venizellos, bazuar në parimet e proklamuar nga Presidenti i SHBA-ve Wilson, të pranuar prej aleatëve, kërkon ndreqjen e padrejtësive që iu bënë Shqipërisë në Konferencën e Londrës 1913-1914, që shkëputi Kosovën në favor të Sërbisë dhe Malit të Zi, Çamërinë në favor të Greqisë, banorët e të cilëve u lanë të vuajnë të këqijat e njohura”.

²⁴ Stavro Vinjau, “Luigj Gurakuqi”, gazeta *Dielli*, nr. 2886 (429), datë 14.7.1925, f. 2, si dhe nr. 2887 (430), datë 16.7.1925, f. 2.

²⁵ *Hylli i Dritës*, nr.3, viti 1944, f. 6-7; S. Vinjau, “Luigj Gurakuqi ...”, nr. 2886 (429), datë 14.7.1925, f. 2, nr. 2887 (430), datë 16.7.1925, f. 2.

²⁶ M. Çami, *Lufta çlirimtare antiimperialiste ...*, f. 71.

²⁷ Zenel Mero, *Revolta e Përmetit*, Tiranë: 2010, f. 21.

kombësisë, dhe mbështeste pretendimet greke për një referendum në Shqipërinë e Jugut, u krijua situatë e vështirë. Delegacioni shqiptar i propozoi konferencës, që me miratimin e saj, para dhe gjatë zhvillimit të referendumit, në ato treva të vinte një kontigjent forcash amerikane.²⁸

Në muajin shkurt 1919, me porosi të Departamentit të Shtetit Amerikan, do të mbërrinte në Përmet konsulli i SHBA-së në Torino, Jozeph Haven, për të parë në vend gjendjen. Haven kishte vizituar shumë qytete e zona të Shqipërisë, duke përfshirë edhe Përmetin dhe kishte vënë re mospajtimin e shqiptarëve me pushtuesin, pavarësisht nga propaganda e tij demagogjike. “Bajoneta italiane” nuk lejonte që populli shqiptar të shfaqte hapur dhe pa frikë dëshirat e tij.²⁹ Para se konsulli të nisej nga Gjirokastra për në Përmet, ishin vënë në dijeni dy intelektualë të njohur, Dhimitër Kacimbri dhe Koço Tasi, të cilët organizuan pritjen. Në atë takim, përmetarët kërkuan që në konferencë të mos mungonte përkrahja e Amerikës, me qëllim “që Shqipëria të fitonte vetëqeverimin e plotë”.³⁰

Sipas Sejfi Vllamasit, në Tepelenë, me inisiativën e Qazim Koculit, ishin mbledhur shumë njerëz nga fshatrat dhe e pritën konsullin të veshur me kostume kombëtare, duke shfaqur simpati për SHBA-në. Edhe në Gjirokastrë, nën drejtimin e kryetarit të Bashkisë Javer Hurshiti, populli i tha Haven-it se donin të jetonin më vete. Por ai u takua dhe me një grup tjetër, që kryesohej nga Lame Kareco, i cili theksoi se, shumica e ortodoksëve ishin për bashkim me Greqinë, pasi nuk mund të bashkëjetonin me muhamedanët.³¹ Ndërsa në Përmet, pritja që në nivel më të lartë dhe nuk pati përçarje midis të pranishmëve, pasi u shprehën njëzëri në favor të çështjes kombëtare.³²

Diplomatit amerikan, gjatë vizitës në Përmet, i kishte bërë përshtypje shkalla e lartë e civilizimit. Krahas burrave, iu paraqitën për takim dhe një përfaqësi e grave përmetare, myslimane dhe të krishtera, të cilat i kërkuan kthimin e Shqipërisë në kufijtë etnikë.³³ Ai vinte nga Gjirokastra, ku komunitetet iu paraqitën të ndara, një grup i veçantë me

²⁸ Muin Çami, *Shqipëria në rrjedhat e historisë. Përmbledhje studimesh 1912-1924*, Tiranë: Onufri, 2007, f. 115-116.

²⁹ Sali Hallkokondi, *Historia e Shqipërisë së re*, Vlorë: 1923, f. 247.

³⁰ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Tiranë: Shtëpia Botuese Marin Barleti, 1995, f. 115.

³¹ *Po aty*, f. 114.

³² *Po aty*.

³³ *Gazeta Dielli*, Nr. 1602, 18 qershor 1919, f. 1.

burra ortodoksë dhe një tjetër me myslimanë. Ndërsa për gratë, nuk bëhej fjalë. Haven-i i pa me sytë e tij të gjitha tablotë e zymta të realitetit përmetar, prandaj, para ikjes, u deklaroi banorëve se kur të shkonte në Amerikë, te Presidenti Wilson, do t'ia bënte të njohura dëshirat dhe porositë që i dhanë.³⁴

Takimet që kishte pasur konsulli amerikan në rrethet Korçë, Leskovik e Përmet, ishin bërë në praninë e shumë njerëzve, të cilët i paraqisnin vetëm një kërkesë: Amerika të bëhej avokate e Shqipërisë; Jugu i vendit të merrej nën protektoratin e saj dhe çështja shqiptare të gjykohej me drejtësi.³⁵ Ardhja e konsullit amerikan në Përmet, u prit me një interesim të veçantë. Gazeta "Albania", në numrin e 11 shtatorit shkruante se, gjatë vizitës së tyre në Gjirokastrë, Përmet e Delvinë, populli u kishte thënë se donte Shqipërinë nën mbrojtjen e Amerikës dhe pa protektoratin e Italisë, "etnografike, të lirë e vetqeverimtare".³⁶

Një nga ngjarjet më të bujshme të asaj vizite, u shënuar në momentin kur disa ushtarakë të milicisë shqiptare, i dorëzuan konsullit amerikan një memorandum. Në të kërkohej largimi i Italisë sepse Shqipëria do t'i zgjidhte vet punët e saj. Në atë çast, dy nënoficerë shqiptarë të milicisë së Përmetit, dolën përpara konsullit duke i thënë se, shqiptarët e duan shtetin e tyre të lirë dhe jo nën varësinë e Italisë.³⁷ Memorandumi provonte, se prania e italianëve në Shqipëri nuk ishte me dëshirën e shqiptarëve, por në dëm të tyre. Ky veprim tregonte se po shfaqej një lëvizje patriotike, e cila godiste politikën e tyre, në zemër të saj.³⁸

³⁴ *The Adriatic Review*, Nr. 8, prill 1919, f. 321, "The Criminal Conduct of Serbia in Albania – President Wilson's investigator reports armistice violation, murders and arrests", by Morton E. Burke, accredited correspondent at the Peace Conference who has just returned from on investigation of condition in the Balkans, f. 314-324.

³⁵ Po aty.

³⁶ "Promemorja, lëvizja politike shqiptare në Shqipëri", *Gazeta Albania*, Nr. 73, dt. 11 shtator 1919 f. 1.

³⁷ *Gazeta Dielli*, Nr. 1583, 26 maj 1919, f. 1. Në gazetë shkruhej, se në mars 1919, shkoi në Përmet i dërguari i Amerikës, që shëtiti tokat e atjeshme, për të parë ndjenjat e vendësve. Një ushtarak shqiptar, që shërbente në ushtrinë italiane, i doli përpara amerikanit dhe i tha atij, se shqiptarët duan shtetin e tyre të lirë dhe jo nën varësinë e Italisë. Qeveria italiane e burgosi oficerin. Ata i kërkuan ndihmë kolonelit italian për ta nxjerrë nga burgu, por ai nuk pranoi dhe ata e vranë atë dhe dy oficerë të tjerë italianë.

³⁸ S. Hallkokondi, *Historia e Shqipërisë së re ...*, f. 249.

Me largimin e Haven-it nga Përmeti, italianët nisën terrorin ndaj personave që thanë të vërtetën në prezencë të konsullit amerikan. Komanda urdhëroi arrestimin e ushtarakëve Demo Korça dhe Bajram Hallko, të cilët u akuzuan për dorëzimin e memorandumit dhe u burgosën.³⁹ Nën vëzhgim u vunë dhe intelektualët që ishin shprehur për pavarësinë e Shqipërisë nga Italia.

Arrestimi dhe burgosja e dy ushtarakëve, krijoi pakënaqësi të madhe në qytet, dhe atë ditë, populli protestoi para zyrave të nënprefekturës dhe dyerve të burgut. Nënprefekti e parandjeu rrezikun, ndaj mbledhi forcat e milicisë dhe punonjësit e pushtetit vendor, të cilët i porositi të ishin të kujdesshëm. Madje, i kërkoi komandës italiane të bënte arrestime të tjera. Dyfishimi i forcave të karabinierisë dhe ushtrimi i dhunës prej tyre, i detyroi protestuesit të shpërndareshin. Më 6 mars 1919, shokë të të burgosurve u përleshën me armë me rojet e burgut, dhe, pasi vranë disa prej tyre, mundën të nxirrnin nga burgu dy të arrestuarit dhe u larguan.⁴⁰

Komanda italiane e dyfishoi kontrollin, por revolta vazhdoi dhe pas disa ditësh u vra në mes të pazarit të qytetit një mareshal i karabinierisë italiane, i cili qe shquar për masa represive ndaj patriotëve shqiptarë. Vrasja e tij ishte fillimi i hakmarrjes qytetare ndaj terrorit ushtarak të pushtuesve.⁴¹ Kjo ngjarje e tronditi rëndë komandën e tyre. Lajmi u përhap në formë alarmi në të gjithë Shqipërinë dhe ngjarja u cilësua si goditja e parë e armatosur kundër pushtuesve. Sipas, Sali Hallkokondit, goditja kundër italianëve në Përmet, ishte e para armë e shenjtë, e para kryengritje kombëtare që e tronditi politikën italiane. Për këtë, gjeneral Ferrero*, “mori qortime të mëdha nga autoritetet e tij”.⁴²

Në raportin e paraqitur pranë Departamentit të Shtetit të SHBA-së, mbi gjendjen në Shqipëri, konsulli Haven shkruante se Jugu i Shqipërisë ishte tërësisht shqiptar. Vetëm një pakicë e vogël e popullsisë, në Korçë e

³⁹ Gazeta *Dielli*, Nr. 1583, 26 maj 1919, f. 1.

⁴⁰ M. Çami, *Lufta çlirimtare antiimperialiste*. . . , f. 74.

⁴¹ *Përmeti gjatë Luftës Nacionalçlirimtare* (Maket për diskutim), Tiranë: 1970, f. 35. Materiali ruhet në Muzeun Historik të Përmetit.

* Gjeneral Giacinto Ferrero ishte komandant i truparmatës XVI italiane të pushtimit në Shqipëri.

⁴² S. Hallkokondi, *Historia e Shqipërisë së Re...*, f. 248.

Himarë, shprehnin ndjenja greke, disa nga frika dhe të tjerë nga premtimet që u ishin bërë.⁴³

Komiteti “Mbrojtja Kombëtare” i Përmetit

Në fund të tetorit 1919, në qytetet Përmet dhe Këlcyrë, u formua Komiteti “Mbrojtja Kombëtare”. Pikësynimi i tij ishte organizimi i përmetarëve kundër okupacionit italian dhe mbrojtja e kufirit me shtetin fqinj. Të dy degët u angazhuan në dobi të çështjes shqiptare, sipas apelit të bërë nga komiteti kombëtar i Vlorës, që u drejtohej zonave të pushtuara nga Italia, si Vlorë, Gjirokastrë e Përmet. Prandaj, patriotët u bënë thirrje bashkëkoharëve të tyre, të bëheshin pjesë e tij, pasi për të pasur një jetë të gëzuar e të lirë, ishte e nevojshme të organizoheshin dhe të bënin mirë detyrat që kishin ndaj atdheut.⁴⁴

Ndërkohë, krerët e komiteteve i mundonte fakti i ndarjes së tyre në bazë të besimeve fetare. Në raportin e muajit janar 1920, të prefekturës së Gjirokastrës, dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, thuhej se në Përmet ishin formuar dy degë të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare”. Njëra prej tyre kishte në përbërjen e vet njerëz të njohur të komunitetit muhamedan, ndërsa tjetra, vetëm me anëtarë të besimit të krishterë.⁴⁵ Duket se krijimi i dy degëve nuk u pëlqye edhe nga drejtuesit e prefekturës, të cilët i këshilluan anëtarët e këtyre komiteteve të gjenin gjuhën midis tyre dhe të bashkoheshin.⁴⁶ Por nuk qe e lehtë, pasi shkëputjen nga Italia disa e shihnin te lufta e armatosur, dhe të tjerë, nuk i përjashtonin marrëdhëniet e afërta me të, sepse mendonin që Shqipëria kishte ende nevojë për miqësinë e saj.⁴⁷

Përmeti kishte gjashtë vjet që administrohej nga qeveria greke dhe më vonë nga ajo italiane. Për këtë shkak, paria e vendit i kërkonte qeverisë shqiptare të dërgonte forca, dhe të merrte nën kontrollin e vet trevën e Përmetit. Nënprefekti i Këlcyrës, pasi kishte kontaktuar me

⁴³ Austin, C. Robert, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit (Demokracia shqiptare në vitet 1920-1924)*, Tiranë: Albin, 2000, f. 131. Raport për Shqipërinë, datë 28 prill 1919, nga Joseph Eereson Haven, american consul at Turin, Italy.

⁴⁴ *Gazeta Dielli*, nr. 1479, 22 mars 1919, f. 1.

⁴⁵ *AQSH*, F. 152/2, V. 1920, D. 234, f. 71. Shkresë e prefekturës Gjirokastrë, Nr. 280, datë 01. 01. 1920, firmosur nga nënprefekti Stavro Vinjau, dërguar MPB.

⁴⁶ *Po aty*, fl. 67. Shkresë e prefekturës Gjirokastrë, Nr. 280, datë 01. 01. 1920, firmosur nga nënprefekti Stavro Vinjau, dërguar MPB.

⁴⁷ *Gazeta Dielli*, nr. 1705, 28 tetor 1919, f. 2.

krerët e qytetit të Përmetit, në mars të vitit 1920, i dërgonte prefekturës një raport, ku midis problemeve që ai shtronte, e vinte theksin në këmbënguljen për të mësuar rreth shkakut, pse qeveria shqiptare s'kishte marrë ende nën administrim rrethet Përmet, Këlcyrë, Leskovik e Gjirokastrë.⁴⁸ Nënprefekti informonte eprorët e vet, se duke parë situatën e ndezur patriotike, kishte marrë iniciativën për t'u thënë të interesuarve, se shumë shpejt do të vinte urdhri për t'u marrë nën zotërimin e qeverisë shqiptare edhe ato zona. Pas kësaj, prefektura e Gjirokastrës i largoi xhandarët shqiptar që ishin nën komandën e karabinierisë italiane dhe priste urdhrin për të marrë në dorëzim trevat jugore në varësi të vet.⁴⁹

Me mbërritjen e lajmit që nënprefektura e Përmetit kalonte nën administrimin e shtetit shqiptar, të krishterët vunë disa kushte. Një prej tyre qe armatosja e disa pjesëtarëve të atij komuniteti, për të mbrojtur qytetin dhe fshatrat e populluara prej tyre. Pra, kërkonin t'i dilnin zot garantimit të sigurisë e qetësisë në krahinat e veta, duke punësuar për këtë qëllim xhandarë prej besimit të krishterë. Ky reagim kishte si shkak hendekun që ishte krijuar midis dy elementeve të besimit, i cili thellohej nga propaganda greke që nxiste përçarjen. Për të shmangur një rrezik të tillë, Komiteti "Mbrojtja Kombëtare" i Këlcyrës, në muajin mars 1920, i dërgonte një memorandum Këshillit të Ministrave, në të cilin theksonte se ishin të vendosur të mbronin me çfarëdo mënyre tërësinë tokësore të Shqipërisë dhe të forconin solidaritetin kombëtar.⁵⁰ Si përfaqësues të

⁴⁸ *AQSH*, F. 149, V. 1920, D. I-86, fl. 1. Raport i nënprefekturës Këlcyrë dhe komandantit të batalionit të xhandarmërisë M. Maksut, Nr. 320, datë 17. 3. 1920, dërguar prefekturës Gjirokastrë, mbi gjendjen në atë rajon. Në këtë letër përmendet dhe biseda që kishte pasur me disa krerë përmetarë. Ndër ta, Neshat Beu, me një shok të tij, u kishte bërë pyetje për kabinetin, se çfarë bënë qeveria dhe pse nuk vjen në Përmet.

⁴⁹ *Po aty*.

⁵⁰ *Po aty*, F. 149, V. 1920, D. I-198, fl. 1-2. Memorandum i Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare Këlcyrë, dërguar Këshillit të Ministrave, dt. 23.3.1920. Në të kërkohej, që të emërohej një prefekt i krishterë. Policia dhe xhandarmëria të përbëhej prej dy elementëve, të krishterë dhe myslimanë. Komandanti të ishte i krishterë, oficerët dhe nënoficerët nga të dy besimet. Të formohej një batalion lëvizës dhe të mbahej aty ku është nevoja dhe qëllimi politik. Të emëroheshin më parë majori, kapitenët dhe togerët, të cilët duhej të organizonin batalionin. Për rroba dhe armë të kujdesej qeveria qëndrore. Projekti i batalionit lëvizës të Përmetit ishte ky: Majori të ishte i krishterë, kapiteni i besimit mysliman, togeri i krishterë dhe nëntogeri myslimanë. Kështu duhej të veprohej dhe ne Leskovik.

popullit të krahinave të Përmetit, Delvinës, Leskovikut, Këlcyrës e Kolonjës, ata propozonin që, krahas marrjes së asaj treve nën administrimin e qeverisë, të bëheshin dhe disa ndryshime në administratë. Qëllimi ishte t'i jepej përparësi elementit të krishterë, gjë për të cilën kishte rënë dakord dhe komuniteti mysliman.⁵¹ Pas kësaj, prefekti i Gjirokastrës i mori parasysh kërkesat e ortodoksëve përmetarë dhe vinte në dijeni kryeministrinë. Sipas nënprefektit të Këlcyrës, miratimi i atij propozimi ishte bërë në dobi të shoqërisë, për të ofruar ortodoksit me shtetin e tyre. Rregullimi i këtyre marrëdhënieve, ishte “me rëndësi politike shumë të madhe për shtetin”.⁵²

Shuarja e këtij konflikti ndër fetar nuk mund të realizohej vetëm me disa reforma organizative. Në radhë të parë duhej të kthjellohej mendja e parisë. Pa u bashkuar dy komitetet e mbrojtjes kombëtare, nuk mund të bëhej propagandë në masën e gjerë të popullit. Kështu, pas debateve të shumta midis krerëve të dy komiteteve, u ra dakord që të mbahej një kongres i përbashkët, për të unifikuar kontributet e tyre në çështjen kombëtare. Ai u zhvillua në lagjen e Mejdenit, në shtëpinë e Hamit Xhungës, ku u formua një komitet i vetëm. Kryetar u zgjodh Baba Xhemali dhe anëtarë, Koço Tasi, Lutfi Përmeti dhe Spiro Kosova, i cili do të kryente dhe detyrën e sekretarit.⁵³ Në atë komitetit, sipas maketit mbi historinë e Përmetit, morën pjesë edhe Stavro Vinjau, Ahmet Kajca, Pirro Plumbi, Ali Këlcyra, Dhimitër Kacimbra, Leonidha Frashëri, Mehmet Pavari, Agathokli Xhitomi, Xhemal Malindi e të tjerë.⁵⁴ Në mbledhjen e parë, komiteti caktoi një zyrë pune dhe propozoi krijimin e trupës së policisë prej 15 vetësh, e cila do të vihej në shërbim të detyrave të komitetit.⁵⁵ Objektivi kryesor i tij qe bashkimi i përmetarëve nën flamurin kombëtar, pa dallim feje. Ndërsa qëllimi final ishte thirrja për t'u inkuadruar në kryengritjen e armatosur çlirimtare.

Komanda italiane e shihte me rrezik konsolidimin e tij, ndaj filloi çarmatimin e çetave shqiptare. Komiteti ngarkoi Kasëm Radovickën të

⁵¹ *Po aty*.

⁵² *Po aty*, F. 149, V. 1920, D. I-86, f. 2. Raport i nënprefekturës Këlcyrë dhe komandantit të batalionit të xhandarmërisë M. Maksut, Nr. 320, dt. 17. 3. 1920, dërguar prefekturës Gjirokastrë, mbi gjendjen në atë rajon.

⁵³ Marenglen Verli, *Shqipëria e viteve 1912-1964 në kujtimet e Spiro Kosovës*, Tiranë: 2008, f 168-169

⁵⁴ *Përmeti gjatë Luftës...* f. 35.

⁵⁵ M. Verli, *Shqipëria e viteve 1912-1964 ...*, f. 169.

shkonte në Këlcyrë dhe të këshillonte krerët e çetave, që të mos u bindeshin urdhrave italiane. Ata ranë dakord me propozimin e Radovickës dhe prematuan se, jo vetëm armët nuk do t'i dorëzonin, por do të qëndronin të bashkuar dhe për gjithçka do të informonin kryesinë e “Mbrotjtjes Kombëtare”.⁵⁶

Kryengritja e Rrëzës

Shtimi i përpjekjeve për bashkim kombëtar, shkaktoi shqetësime në radhët e italianëve dhe të grekëve. Shqipëria ende nuk kishte saktësuar kufijtë dhe të dy fqinjët shpresonin të përfitonin në bazë të marrëveshjes që kishin bërë midis tyre. Qëllimi ishte t'i përcillnin konferencës mesazhin se, në Përmet, banorët e dy besimeve nuk mund të bashkëjetonin pa një mbikëqyrës, dhe se, një pjesë e popullsisë së asaj treve nuk e donte qeverinë shqiptare. Për të realizuar kundërvënien midis përmetarëve të një gjaku, hapën fjalë se në fshatrat e krahinës së Rrëzës ishin duke shkuar myslimanët, me qëllim që të vrisnin, plaçkitnin e digjin katundet.⁵⁷ Italianët, stimuluan krijimin e një komiteti të emërtuar, “Hakmarrja”, me të cilin synonin të nxisnin vëllavrasjen.⁵⁸

Për ndezjen e konfliktit ndërfaqësor, u organizuan atentate ndaj dy grekomanëve të njohur, Lake Kosinës dhe Qiro Vasos në Tremisht. Ky veprim u shoqërua me një propagandë të fortë, për të rrënjësuar bindjen te popullsia ortodokse, që atentati u krye nga myslimanët. Në këtë mënyrë, krijohej mendimi se në atë trevë qe e pamundur të bashkëjetonin të krishterë e myslimanë. Për të ndezur me tej gjakrat, krahas propagandës në radhët e banorëve të besimit të krishterë, italianët shpërndanë edhe armë për ta.⁵⁹

Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare” e kuptoi qëllimin e përfaqësuesve të Romës dhe bëri përpjekje për të bindur njerëzit të mos e besonin një propagandë të tillë, por efekti ishte i dobët. Nga frika e grupimit “Hakmarrja”, fshatarët ortodoksë të Kaludhit, Strembecit, Pëllumbarit,

⁵⁶ *Po aty*, f. 170.

⁵⁷ *AQSH*, F. 313, V. 1920, D. 4, fl. 2. Raport i nënprefekturës Këlcyrë, Nr. 351/10, dt. 26.3.1920. Mbi ngjarjen e lëvizjes së Rrëzës së Nemërçkës, dërguar prefektit të Gjirokastrës. Shkresa firmoset nga nënprefekti dhe komandant i batalionit të xhandarmërisë, majori Mustafa Maksut.

⁵⁸ S. Adhami, *Përmeti dhe përmetarët...* f. 479.

⁵⁹ *AMPJ*, F. 151, V. 1920, D. 60, fl. 3, Raport i nënprefekturës Përmet, mars 1920, dërguar MPJ, pa datë.

Draçovës, Zhepës, Biovizhdës, Vllaho-Psilloterës, nga mesi i muajit mars 1920, filluan të shpërngulnin familjet e tyre për në tokën greke.⁶⁰ Ky veprim, u shoqërua me shtimin e bandave, ku veçoheshin emra të tillë kryebanditësh, si Josif Suropulli dhe Çuli Premti. Ata kalonin fshat më fshat dhe terrorizonin njerëzit, plaçkitnin dhe keqtrajtonin fshatarët që manifestonin ndjenja patriotike shqiptare.⁶¹ Në fillim të vitit 1920, hyrja e terroristëve grekë brenda kufirit shqiptar, ishte bërë e zakonshme. Shkaktimi i trazirave prej tyre, jo vetëm në trevën e Përmetit, por edhe në atë të Gjirokastrës, Kolonjës dhe Korçës, u përsërit disa herë. Për të siguruar kufirin në vijën që mbulonte prefektura e Gjirokastrës, u propozua formimi i “një batalioni gjindarmërie me 240 veta”.⁶²

Meqenëse problemet më të shpeshta kishin qenë në territorin Përmet-Kolonjë, të dërguarit e ministrisë propozonin si qendër të këtij batalioni qytetin e Këlcyrës. Ata jepnin mendim edhe për emërimin e majorit të xhandarmërisë, Mustafa Maksuti, në detyrën e komandantit të batalionit⁶³, por nevojitej të bëhej dhe zëvendësimi i drejtuesve të nënprefekturave. Në krye të tyre duhej të ishin njerëz më të zotë, me mprehtësi politike por dhe të guximshëm, për t’u dhënë rrugëzgjdhje problemeve. Prandaj u kërkua që në Leskovik të emërohej Kolë Rodha, në Kolonjë, Ali Frashëri dhe në Këlcyrë, Mustafa Maksuti.⁶⁴

Këshilli i Ministrave, pasi ishte njohur hollësisht me gjendjen në kufijtë jugor, me vendimin e datës 29 shkurt, miratoi krijimin e batalionit të xhandarmërisë prej 240 vetë, me qendër në Këlcyrë. Në të njëjtën ditë, njoftohej zyrtarisht kapiten Mustafa Maksut, se ishte emëruar komandant i batalionit të xhandarmërisë dhe njëkohësisht, nënprefekt i qarkut të Këlcyrës, për të cilën duhej të fillonte nga puna një orë e më parë.⁶⁵

Komiteti “vorio-epirot” i Athinës, aktivizoi degët e tij në Janinë e Korfuz, për të nxitur revoltën në krahinat kufitare, me qëllim që të krijoheshin kushtet për të “marrë masat më të nevojshme dhe më të

⁶⁰ *Përmeti gjatë Luftës ...*, f. 35.

⁶¹ *Po aty*, f. 33.

⁶² *AQSH*, F. 152/2, V. 1920, D. 136, fl. 1, Shkresë e Delegatisë së Punëve të Brendshme, drejtuar Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Durrës 21. I. 1920.

⁶³ *Po aty*.

⁶⁴ *Po aty*.

⁶⁵ *Po aty*, fl. 2.

pëlqyera në këto vise”.⁶⁶ Josif Strembeci me 20 grekomanë të tjerë, të përkrahur nga sillogu i Janinës ngritën flamurin e kryengritjes dhe deklaruan se, krahina e rRëzës nuk e njihte autoritetin e shtetit shqiptar. Ata mundën të bënin për vete rreth 150 vetë. Kryengritësve u premtohej se në momentin që ata do të ngrinin krye, do të vinin forca ushtarake nga Greqia për të pushtuar ato vise dhe do të shpëtonin një herë e mirë nga e keqja.⁶⁷

Në një raport që i dërgohej MPJ, jepeshin dhe emrat e disa personave që kishin luajtur rol aktiv në atë lëvizje, si Josif Strembeci, Stilara nga Leskoviku, Andrea Papa Jorgji, Kolo Tase e Sevo Pëllumbari.⁶⁸ Kjo kryengritje e vogël solli shqetësim në qarqet politike shqiptare, pasi ishte koha kur në Shqipëri pritej të vinin përfaqësuesit e Komisionit Ndërkombëtar të Kufijve. Ata duhej të shihnin me sytë e tyre, që banorët e disa krahinave, nuk pranonin të viheshin nën administrimin e qeverisë shqiptare.⁶⁹ Për pasojë, brenda dy ditëve, ajo u bë aktive dhe njëkohësisht shqetësuese, pasi hapi panik ndër banorët. Për të inkurajuar veprimin e kryengritësve, në zonën Konicë-Leskovic, ishin përqendruar trupa të shumta greke, të cilët dëshironin, që kjo lëvizje të shtrihej në gjithë zonën e jugut.⁷⁰

Nënprefektura e Këlcyrës, informonte prefektin e Gjirokastrës, rreth lëvizjes antishqiptare që po zhvillohej në krahinën e Rëzës së Nemërçkës. Ajo bënte fjalë për një çetë andarte, të përbërë nga disa anëtarë prej katundeve Strembec, Kaluth, Pëllumbar, Kanikol, Draçovë, Zhepë, Biovizhdë, Vllaho, Psilloterë e gjer në Mesaré. Grupet e armatosura lëviznin fshat më fshat, për të krijuar panik ndër banorët.⁷¹ Për nënprefekturën nuk kishte dyshim që trazirat e ndodhura në katundet

⁶⁶ *Po aty*, F. 152, V. 1920, D. 68, fl. 2, Shkresë e nënprefekturës Përmet, Nr. 23, datë 30. 3. 1920, drejtuar M. P. Brendshme, Tiranë.

* Krahina e Rëzës përfshin disa fshatra, që shtrihen shpat malit Nëmerçkë, në të majtë të rrjedhjes së lumit Vjosë, në afërsi me kufirin grek.

⁶⁷ *AMPJ*, F. 151, V. 1920, D. 60, f. 4. Raport i nënprefekturës Përmet, mars 1920, dërguar MPJ, pa datë.

⁶⁸ *Po aty*.

⁶⁹ *Po aty*, F. 152/2, V. 1920, D. 234, fl. 8, Raport i nënprefekturës Klisurë, Nr. 382, datë 9. 4. 1920, dërguar Prefekturës Gjirokastrë.

⁷⁰ *Arkivi Historik i Muzeut të Përmetit*, Dosja që përmbledh vitet 1900-1920.

⁷¹ *AQSH*, F. 313, V. 1920, D. 4, fl. 1. Shkresë e nënprefektit të Këlcyrës, M. Maksut, Nr. 351/10, datë 26. 3. 1920, për prefekturën Gjirokastrë.

e Rrëzës së atij rrethi, ishin produkt i propagandës italiane. Sipas filozofisë së tyre, një popull i përçarë është më lehtë për t'u sunduar. Në raport vihej në dukje se më 21 mars, Primari i Zhepës* ishte lajmëruar që në Biovizhdë dhe Vllaho-Psilloterë qarkullonin grupe andartësh, me synim nxitjen e të rinjve të atyre viseve, që të kalonin brenda kufirit grek.⁷²

Njoftimi për ikjen e djemve që verifikuar nga disa burime. Lajmi pati krijuar shqetësime në qarqet zyrtare, por qeveria nuk kishte mundur t'i vinte para përgjegjësishë organizatorët që e nxisnin largimin e tyre. Pas disa muajve, një pjesë e të larguarve u kthyen dhe u pritën me ngrohtësi nga zyrtarët e shtetit, si njerëz të gënjer prej propagandës helene dhe prej ndonjë grekomani, siç ishte rasti i Mantho Buxhukut që nxiste largimin e të rinjve, gjë për të cilën iu dha gjyqit.⁷³

Ndikimi italian në këto trazira bëhej më i besueshëm, kur vetë kryengritësit e Rrëzës kërkonin mbrojtjen e qeverisë së Romës.⁷⁴ Banditët i shpeshuan veprimet terroriste, sapo u informuan, që shteti shqiptar kërkonte të merrte nën kontrollin e vet gjithë territorin e vendit. Ata shpreheshin hapur, se nuk pranonin të ishin nën varësi të qeverisë shqiptare. Një gjë të tillë ua bënin të njohur dhe njerëzve që takonin në rrugë. Për të krijuar opinionin, se në atë krahinë nuk kishte siguri, andartët plaçkitnin udhëtarët dhe pasi i rrihnin, i linin të lirë.⁷⁵

Fillimisht mendohej se kryengritësit ishin të gjithë të ardhur nga Greqia, por një fshatar nga Strembeci, të cilin e patën ndaluar në rrugë, deklaronte se midis personave të armatosur, që përfaqësonin anëtarët e "kryengritjes së Rrëzës", kishte edhe banorë të atyre fshatrave, disa prej të cilëve ai i kishte njohur.⁷⁶ Të njëjtën gjë pohonte dhe Esat Isuf

* Zhepa ishte qendër e Primaries (Krahinës N. D.) së Rrëzës.

⁷² *AQSH*, F. 313, V. 1920, D. 4, f. 2. Raport i nënprefekturës së Përmetit, datë 30. 3. 1920, dërguar Prefekturës Gjirokastër.

⁷³ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri 1912-1924*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2013, f. 332.

⁷⁴ *AMPJ*, F. 151, V. 1920, D. 60, fl. 3, Raport i nënprefekturës Përmet, mars 1920, dërguar MPJ, pa datë.

⁷⁵ *AQSH*, F. 313, V. 1920, D. 4, fl. 2, Raport i nënprefekturës Përmet, datë 30. 3. 1920, dërguar Prefekturës Gjirokastër.

⁷⁶ *Po aty*.

Pagria**, i cili njohu disa fshatarë nga Pëllumbari.⁷⁷ Mbështetja e kryengritësve nga italianët, kuptohej lehtë edhe nga mënyra e sjelljes së vetë anëtarëve të çetës andarte. Ata deklarorin se kishin rrëmbyer armët për të vendosur qetësinë, pasi, sipas tyre, shqiptarët s'ishin të zotë të mbanin rendin. Ata nuk do t'i hiqnin armët, në rast se situatën nuk e merrte në dorë ushtria italiane. Sipas tyre rendi mund të garantohej, vetëm nëse ato vise do të merreshin nën kontrollin e karabinierisë italiane.⁷⁸

Ndërkohë, përhapeshin dhe fjalë se gjoja territoret që merreshin nën kontrollin e shtetit shqiptar, po digjeshin dhe shkatërroheshin.⁷⁹ Për të pasur tërësisht situatën në dorë, andartët u bënë presion me armë komandës së postës së xhandarmërisë, për ta detyruar të largohej. Përballë dhunës së ushtruar prej më se 100 andartëve, komandanti i grupit të xhandarmërisë, që përbëhej nga 7 veta, u detyrua të linte vendkomandën.⁸⁰

Për të marrë takim me kryengritësit në atë krahinë, kishte shkuar kapiteni i xhandarmërisë, Leonidha Frashëri, dhe përfaqësues nga Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare” i Përmetit, Agathokli Zhitomi.⁸¹ Ata biseduan me shumë prej banorëve që ishin duke ikur dhe tentuan t'i bindnin, por me gjithë përpjekjet për t'i kthyer familjet pranë shtëpive të veta, numri i atyre që u bindën ishte i paktë. Sipas nënprefektit Pirro Plumbi, shumë prej fshatarëve kishin rënë viktimë e propagandës

** Shkronjës i Primaries së Rrëzës, qe ndaluar nga banda “kryengritëse” në kohën kur kthehej nga Përmeti për të shkuar në qendër të Primaries. Këtë, si dhe të parin, e kapën pranë katundit Pëllumbar, pasi i kontrolluan, i gjetën një revolver dhe disa letra personale, të cilat ia kthyen përsëri dhe e porositën të mos trembej dhe se ishte i lirë të shkonte ku të donte. E porositën të shkonte në Primari dhe të largoheshin, pasi rruga do të zihej dhe nuk do të kishin mundësi të iknin.

⁷⁷ AQSH, F. 313, V. 1920, D. 4, fl. 2-3, Raport i nënprefekturës Përmet, mbi ngjarjet e katundeve të Rrëzës, datë 30.3.1920, dërguar prefekturës Gjirokastrë.

⁷⁸ Po aty.

⁷⁹ AMPJ, F. 151, V. 1920, D. 60, f. 3, Raport i nënprefekturës Përmet, mars 1920, dërguar MPJ, pa datë.

⁸⁰ Po aty, fl. 3.

⁸¹ Po aty.

armiqësore. Për pasojë kishin lënë shtëpitë dhe me gjithë familje kishin shkuar në shtetin grek.⁸²

Konsullata italiane ishte e mendimit se të larguarit nuk kishin urrejtje ndaj Shqipërisë apo dashuri për Greqinë, por patën ikur për t'iu shmangur shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Madje, sipas tyre, një veprim të tillë e kishin kryer dhe shumë myslimanë, kryesisht nga prefektura e Gjirokastrës. Negativisht besohet të ketë ndikuar dhe pakënaqësia e krijuar për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike, rritjes së tarifave doganore, e cila shihej si xhelozia e diferencave ekonomike midis të krishterëve dhe myslimanëve, apo sepse këta të fundit, shfaqnin pretendimin që, kohë më parë, kanë qenë dëmtuar prej ortodoksëve dhe që krijuar një farë mosbesimi midis njeri-tjetrit.⁸³ Në fakt ushqej një frymë antimuslimane, e cila nxitej nga politika greke, për shkak të dominimit të qeverisë nga bejlerët.⁸⁴

Gjithsesi, përpjekjet e qeverisë për të këshilluar banorët të mos largoheshin nga shtëpitë e tyre, vazhduan pa ndërprerje. Me qëllim që të arrihej rezultat i kënaqshëm, në përbërje të këtij komisioni kishte anëtarë “nga parësia e të krishterëve dhe muhamedanëve”.⁸⁵

Nënprefektura e Përmetit dërgoi njerëz të posaçëm, për të mësuar më shumë rreth shkaqeve. Edhe komanda e xhandarmërisë së nënprefekturës, kishte nisur togerin Ali Muhtar, me 22 xhandarë, të shkonin fshat më fshat për t'u informuar më gjerësisht. Qëllimi i tyre ishte, të ndalonin përhapjen e kësaj lëvizjeje ndër fshatra e krahina të tjera.⁸⁶ Me të mbërritur në vend, ata u bashkuan me grupin e xhandarëve të Rëzës prej 7 vetash dhe zunë pikat e duhura mbi Kaludh, për të evituar gjithçka të papritur. Sipas informacionit që patën marrë nga banorët vendas, rezultonte se

⁸² *AQSH*, F. 152, V. 1920, D. 234, fl. 3, Shkresë e nënprefektit të Përmetit, Pirro Plumbi, Nr. 605, dt. 3 prill 1920, dërguar prefekturës Gjirokastrë, në përgjigje të shkresës së saj Nr. 1851, dt. 30 mars 1920.

⁸³ B. Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar ...*, f. 332-333.

⁸⁴ *Po aty*, f. 333. Kjo u duk qartë në zgjedhjet e vitit 1921, kur shumë ortodoksë të Gjirokastrës dhe Korçës nuk do të merrnin pjesë në zgjedhje. Në momarandumin e ortodoksëve të Korçës, të datës 19 shkurt 1921, thuhej qartë se ortodoksët nuk do të merrnin pjesë në votime për të shpëtuar kombin nga rreziku i qeverisjes orientale të shtetit shqiptar.

⁸⁵ *AQSH*, F. 313, V. 1920, D. 4, fl. 1, Shkresë e nënprefektit të Këlcyrës, M. Maksut, Nr. 351/10, datë 26. 3. 1920, për prefekturën Gjirokastrë.

⁸⁶ *Po aty*, F. 313, V. 1920, D. 4, fl. 3, Raport i nënprefekturës Përmet, mbi ngjarjet e katundeve të Rëzës, datë 30.3.1920, dërguar prefekturës Gjirokastrë.

numri i kryengritësve ishte rreth 120 vetë. Prandaj, ishte menduar mbledhja e një kompanie xhandarësh prej 150 vetë, të cilët do të afroheshin në fshatrat ku vepronin kryengritësit.⁸⁷ Për të rritur shkallën e sigurisë, komanda kishte nisur në ndihmë të forcave të saj edhe 20 xhandarë të tjerë, që komandoheshin nga kapiten Leonidha Frashërit.⁸⁸ Por, me gjithë garancitë e dhëna, kryengritësit nuk pranuan t'u bindeshin përfaqësuesve të xhandarmërisë, duke u shprehur, se ishin nën komandën italiane dhe me leje të qeverisë italiane.⁸⁹ Ata mund të qetësoheshin, vetëm në rast se një gjë të tillë do t'ua kërkonte ndonjë karabinier italian, në të kundërt, nuk do t'i linin armët dhe se nuk e njihnin xhandarmërinë shqiptare.⁹⁰

Kryengritësit nuk u mjaftuan me kaq, por gjetën momentin dhe hapën zjarr mbi forcat e xhandarmërisë.⁹¹ Në këto kushte, xhandarmëria u detyrua t'u përgjigjej në të njëjtën mënyrë, për t'u vetëmbrojtur. Por, komanda italiane e thelloi më tej marrjen e masave për destabilizim të rendit. Ajo liroi kriminelët e burgosur dhe i organizoi në banda për të goditur fshatarët patriotë. E informuar rreth veprimeve të tilla, xhandarmëria kërkoi ndihmën e Komitetit "Mbrojtja Kombëtare", i cili i bëri thirrje popullit të Përmetit të armatosej dhe të mbronte qytetin. Përmetarët, iu përgjigjën thirrjes menjëherë dhe u vunë në mbështetje të operacionit të xhandarmërisë. Kjo bëri që kryengritësit të tërhiqeshin dhe kaluan kodër pas kodre, derisa dolën në Greqi, pa marrë me vete as plaçkat e grabitura me dhunë.⁹²

Me kujdesin e treguar nga xhandarmëria shqiptare, më 25 mars, kishte marrë fund marrëzja e kësaj lëvizjeje, pa pasur dëme në të dy anët.⁹³ Por ngjarja nuk kaloi pa pasoja në radhët e banorëve. Ndonëse kryengritësit ishin larguar, paniku kishte mbetur aty, midis popullsisë. Madje, edhe në ditët në vijim, disa familje nga këto fshatra, nën

⁸⁷ *Po aty*, fl. 1.

⁸⁸ *Po aty*, fl. 3.

⁸⁹ *Po aty*.

⁹⁰ *Po aty*, fl. 1.

⁹¹ *AQSH*, F 313, V. 1920, D. 150, fl. 1.

⁹² *Po aty*, F. 313, V. 1920, D. 4, fl. 3, Raport i nënprefekturës Përmet, datë 30. 3. 1920, dërguar Prefekturës Gjirokastër.

⁹³ *Po aty*, F. 152, V. 1920, D. 234, fl. 10, Raport i nënprefekturës Klisurë, Nr. 382, datë 9. 4. 1920, dërguar Prefekturës Gjirokastër.

pretekstin e frikës, do të vazhdonin të shkonin drejt shtetit fqinj.⁹⁴ Gjithsesi, forcat shtetërore “dëftyen disiplinë të pëlqyer dhe mëshirë të plotë kundrejt popullit”.⁹⁵

Qeverisë i duhej punë për të shuar panikun e krijuar midis banorëve të mbetur. Nënprefektura e Përmetit, më 3 prill, raportonte se Përmeti zotërohej tërësisht nga forcat qeveritare dhe se ishin marrë masa të forta për të vendosur rendin. Në rastet kur, individ apo grupe të tyre, kishin ngritur krye, ishin shtypur me dhunë, duke vendosur qetësinë.⁹⁶

Në ndihmë të qeverisë ishin intelektualët përmetarë. Ata organizuan një protestë, për të cilën u vu në dijeni dhe nënprefektura e Këlcyrës. Nacionalistët e asaj treve po përgatisnin dhe një memorandum, ku përcaktoheshin masat që duheshin marrë.⁹⁷ Në atë atmosferë, jo fort të pëlqyeshme, populli i trevës së Përmetit u mbledh më 3 prill në një miting, ku morën pjesë mbi 3.000 vetë. Ata protestuan kundër intrigave të huaja, që u manifestuan qartë me kryengritjen e krahinës së Rrëzës.⁹⁸ Tubimi u zhvillua nën kryesinë e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare” dhe të gjithë ata që patën marrë fjalën, e kishin vënë theksin në ruajtjen e dashurisë dhe vëllazërisë midis përmetarëve, pavarësisht nga besimi të cilit i përkisnin.⁹⁹

Komisioni i mitingut* lëshoi një deklaratë, ku theksohej se cilëtdo qofshin shkaktarët e turbullirave, në dëm të pavarësisë së Shqipërisë, kishin për qëllim të justifikoheshin para opinionit botëror, për atë çfarë

⁹⁴ *Po aty*, F. 313, V. 1920, D. 4, fl. 1, Raport i nënprefekturës Këlcyrë, Nr. 351/10, dt. 26.3.1920. Mbi ngjarjen e lëvizjes së Rrëzës së Nemërçkës, dërguar prefektit të Gjirokastrës. Shkresa firmoset nga nënprefekti dhe komandant i batalionit të xhandarmërisë, majori Mustafa Maksut.

⁹⁵ *Po aty*, F. 152/2, V. 1920, D. 234, fl. 9, Raport i nënprefekturës Klisurë, Nr. 382, datë 9. 4. 1920, dërguar Prefekturës Gjirokastrë.

⁹⁶ *Po aty*, fl. 10, Raport i nënprefektit të Klisurës dhe njëkohësisht komandanti i Batalionit të Gjindarmërisë, Major Mustafa Maksuti, datë 9. 4. 1920, dërguar prefekturës Gjirokastrë.

⁹⁷ *Po aty*, F. 152/2, V. 1920, D. 68, fl. 2, Shkresë e nënprefekturës Përmet, Nr. 23, datë 30. 3. 1920, drejtuar M. P. Brendshme, Tiranë.

⁹⁸ *Po aty*, F. 313, V. 1920, D. 4, fl. 5, Nënprefektura e Përmetit, raport për ministrinë e Punëve të Brendshme, datë 3 prill 1920.

⁹⁹ *Po aty*, F. 313, V. 1920, D. 150, fl. 5.

* Komisioni i mitingut përbëhej nga Thoma Mihailidhi, Ylli Kristaq Stavridhi, Sotir Tako, Mino Duci, Papa Sotiri, Irfan Muftar, si dhe dy emra të tjerë që janë të palexueshëm.

bënin dhe objektivat që synonin të arrinin.¹⁰⁰ Pjesëmarrësit në miting shpreheshin të kënaqur me qetësinë e vendosur, pas marrjes së këtyre viseve prej xhandarmërisë shqiptare.¹⁰¹

Sherr në kishën e Shën Kollit

Më 11 prill 1920, ditën e Pashkëve, në kishën e Shën Kollit në Përmet, trupat italiane mbështetën mitropolitin dhe disa grekomanë, për të celebruar festën në gjuhën greke. Patriotët, që u ndodhën aty, e kundërshtuan këtë plan dhe kërkuan që mesha të zhvillohej në gjuhën shqipe, por synimi italian nuk u pengua tërësisht. Disa nga të pranishmit mbështetën grekomanët për variantin e meshës në greqisht, duke u bërë shkak për nxitjen e një sherri midis besimtarëve ortodoks. Karabinierët italianë shihnin me kënaqësi, se plani i tyre po funksiononte, ndaj mbyllën dyert e kishës dhe rrethuan godinën, me shpresë se shqiptarët do të kacafyteshin brenda mjediseve të saj, duke parashikuar edhe viktima. Për fat, qëllimi i tyre dështoi, sepse në kishë mbërritën përfaqësuesit e Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare”, të cilët larguan karabinierët dhe qetësuan situatën.

Në njoftimin zyrtar të policisë thuhej se, pasi “nisi këndimi fetar, një pjesë meshuan duke thënë “Kristos Anesti” dhe të tjerët “Krishti u ngjall”. Por grupit të dytë i prishej ceremonia nga ata që meshonin në gjuhën greke. Për këtë shkak, “midis tyre ndodhi një rrahje me duar”.¹⁰² Incidenti ishte bërë me iniciativën e Mandi Adhamidhit, i cili kishte angazhuar disa djem të rinj për të ndaluar himnin në gjuhën shqipe dhe të këndonin greqisht.¹⁰³ Italianët ndërhyjnë dhe tentuan t’i jepnin rëndësi çështjes, por xhandarmëria shqiptare u dha të kuptonin, se kjo nuk ishte punë e tyre.¹⁰⁴ Përpjekje për të qetësuar gjendjen u bënë dhe nga agjenti i policisë, Pano Simollari, por për fat të keq, himni shqip ishte ndërprerë disa herë.

¹⁰⁰ *AQSH*, F. 313, V. 1920, D. 4, fl. 5, Nënprefektura e Përmetit, raport për ministrinë e Punëve të Brendshme, datë 3 prill 1920.

¹⁰¹ *Po aty*.

¹⁰² *Po aty*, F. 152/2, V. 1920, D. 68, fl. 3, Informacioni mban datën 18 prill 1920, firmosur nga zëvendësnprefekti dhe komandant i batalionit të xhandarmërisë, Major Maksut Mustafa.

¹⁰³ *Po aty*, fl. 7.

¹⁰⁴ *Po aty*, fl. 3.

Grindja kishte krijuar panik midis të pranishmëve dhe sidomos grave, të cilat “vraponin të linin kishën duke u shtyrë”.¹⁰⁵ Në vendngjarje mbërritën menjëherë të dy formacionet ushtarake të mbrojtjes së rendit: karabinieria shqiptare dhe ajo italiane. Italianët kishin kërcënuar se do të qëllonin me mitraloz, në rast se do të cenoheshin civilët. Dhe, në sy të besimtarëve, u kishin dhënë porosi ushtarëve të vet, të sillnin aty një mitraloz. Por ky veprim nuk u krye, për shkak se karabinierët shqiptarë u thanë homologëve italianë, që një veprim i tillë ishte jo vetëm i nxituar, por dhe i paarsyeshëm. Vendosja e armatimit të rëndë para kishës, mund të shoqërohej me acarim të situatës dhe daljen e saj jashtë kontrollit, për të cilën xhandarët vendas deklarorin se nuk mbanin përgjegjësi.¹⁰⁶

Prefektura e Gjirokastrës njoftoi ministrinë për trazirat në katundet e Rrëzës dhe ngjarjet në Kishën e Shën Kollit të Përmetit. Sipas saj, ato ishin të nxitura nga propaganda e huaj, me qëllimin e njohur të mbjelljes së përçarjes në radhët e përmetarëve.¹⁰⁷ Në raportin e përgatitur nga organet e rendit jepeshin hollësisht, ku nuk mungonin dhe emra të personave përgjegjës, si Mandi Adhamidhi nga Buhali, Qirjako Kote Maskuli, Apostol Kosta Lole, Gore Dindi, Vasil Rusi, Josif Proko, Lluka Bibi, etj.¹⁰⁸

Grekomanët, nisur nga raportet e mira që ishin krijuar midis italianëve dhe grekëve, shpresonin në ndërhyrjen e karabinierëve italianë. Kjo del qartë nga raporti që i dërgonte Ministrisë P. Brendshme nënprefektura, në të cilin shprehej dyshimi rreth planit italian. Mosndërhyrja e karabinierëve u kishte prerë krahët disa prej shkaktarëve që kishin shpresuar në mbrojtjen e tyre.¹⁰⁹ Nga ana e italianëve, pati tentativa për ta rënduar situatën, pasi ata raportorin tre të vrarë. Madje,

¹⁰⁵ *Po aty*, F. 152/2, V. 1920, D. 68, fl. 8, Në shkresën e nënprefekturës jepen dhe hollësi. Vasil Rusi u ngrit nga vendi ku ishte ulur dhe kapi për krahu Gore Dindin dhe duke u shtytur u goditën. Pas kësaj, u grind dhe Lluka Bibi me Josif Prokon. Kjo bëri, që disa prej tyre të shëmben, për shkak të rrëzimit në tokë dhe humbën mjaft sende të çmuara, si vathë etj. Pastaj çështja u qetësua dhe përveç dy grave, që u ra zali (vilani) nga frika, nuk ndodhi gjë tjetër.

¹⁰⁶ *Po aty*.

¹⁰⁷ *Po aty*, F. 152/2, V. 1920, D. 68, fl. 6. Shkresë e Prefekturës Gjirokastrë, Nr. 2280, datë 33. 4. 1920, drejtuar M. P. Brendshme, Tiranë.

¹⁰⁸ *Po aty*, fl. 7, Raport i N/Prefektit Pirro Plumbi, dërguar Prefekturës, datë 11 prill 1920. Të gjithë janë banorë të Përmetit.

¹⁰⁹ *Po aty*, fl. 6.

në raportin e tyre thuhej se grindja kishte ndodhur “midis shqiptarëve dhe grekëve”¹¹⁰ Në fakt, grindja kishte ndodhur midis shqiptarëve të njëjtit besim. Shkaktarë qenë disa djem gjaknxehtë, të nxitur nga dikush, apo të ndikuar nga politika e fqinjëve dhe nuk kishte pasur asnjë të vrarë.¹¹¹

Pas këtyre ngjarjeve, shteti e kuptoi më mirë rrezikun që kanosej, ndaj vendosi për të dërguar kontigjente ushtarake shtesë, për të siguruar kufirin jugor. Nënprefekurat e Jugut u porositën të punonin më seriozisht për forcimin e vetëdijes kombëtare, ndërsa prefektura i kërkonte qeverisë krijimin e dy batalioneve në jug të vendit, me myslimanë dhe të krishterë, luftëtarët e të cilëve do të ishin nga Leskoviku, Përmeti, Këlcyra e Kurveleshi.¹¹² Në këto rrethana, “Mbrojtja Kombëtare” e Përmetit i dha ultimatum ushtrisë italiane të largohej brenda 48 orëve. Më 18 prill 1920, italianët lanë Përmetin dhe të nesërmen u larguan edhe nga Këlcyra, duke zbrazur në këtë mënyrë, qendrën e lëvizjes kombëtare të atyre viseve.¹¹³

S u m m a r y

THE REGION OF PERMET DURING THE ITALIAN OCCUPATION (1916-1920)

During the Italian occupation of Albania the sub-prefecture of Permet was in a miserable state as a consequence of the earlier fights against the Greek forces in which many people had been killed, hundred of houses had been burned down and thousands of people had been forced to flee to Vlora and Berat under the threat and terror of the Greek army.

The inhabitants of Permet were initially happy by the arrival of the Italians who promised to make the Greek paramilitary troops leave the region and bring back normality to their everyday life. However, Italy's aim was the colonization of the southern regions of Albania. This proved to be a difficult task as the Austro-Hungarian forces situated on the opposite side of the Osum river would not allow it, and on the other hand, Athens supported by France and Russia had not given up its claims to “Northern Epirus”.

In the Peace Conference of Versailles, Italy asked to be issued the protectorate of Albania thus declaring openly its true objectives. Moreover, the

¹¹⁰ *Po aty*.

¹¹¹ *Po aty*.

¹¹² *Po aty*, F. 152, V. 1920, D. 31, fl. 6.

¹¹³ *Gazeta Drita*, Nr. 8, 22 maj 1920, f. 2.

Titoni-Venizelos Pact was made public and worsened the Italian-Albanian relations as in it, Italy had agreed to allow the southern regions of Albania like Sarande, Gjirokaster, Permet and Korce to be included within greater Greece. However, the European powers did not agree with this pact and asked Italy to denounce it and at the same time asked Greece to withdraw its forces and respect the borders established in 1913.

These events had made Albanians lose their trust in Italy and consider the Italians as invaders. On 18 February 1919 the inhabitants of Permet protested against the secret plans for the repartition of Albania. The participants of this demonstration declared that they were ready to make any sacrifice for their country, and they would fight till the end to defend Albanian soil.

Considering that the Peace Conference had left aside the Albanian requests to solve the territorial issues with Greece based on the principle of nationality, while the Greek claims for holding a referendum in South Albania had been heard and supported, the Albanians turned to the US for help. The Department of State sent its consul, Josef Haven, to check what the situation was like. He came to the conclusion that in South Albania there was no harmony between Albanians and their invaders, while the people, both Muslims and Christians, wanted to be self governed.

Some officers of the Albanian militia submitted to the American consul a memorandum in which asked from Italy to leave Albania. They also told the consul that the Albanians wanted to be free and independent from the Italians. The memorandum was a testimony that Albanians did not support the presence of Italians in their country and considered it as harmful for their national interests.

The Committee of National Defense in Permet wanted their sub-prefecture to be administered by the Albanian government but this attempt was contradicted by an anti-Albanian movement organized by the Greek forces and some pro-Greek Orthodox Albanians. In order to avoid such a risk, The Committee of National Defense in Kelcyre, in March 1920 sent a memorandum to the Council of Ministers, in which expressed its determination to defend at every cost the territories of Albania and to strengthen the national solidarity. As representatives of the regions of Permet, Delvine, Leskovik, Kelcyre and Kolonje, they also proposed the government that apart from taking under control these regions to apply also some administrative changes. They wanted to empower the Christian inhabitants of these regions and the Muslim population had given its consent. This act strengthened the unity between the two groups and was one of the reasons that forced Italy to leave the country.

